

## Shtojca 12

( Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

### **TERMAT E REFERENCËS**

#### **Pershkrimi i detyres**

Sistemi qe kerkohet per administrimin financiar duhet te jete i tipit COTS (Commercial Off The Shelf) duke u bazuar nga ana teknologjike ne paketa nderkombetare te ndertuara mbi bazen e praktikave me te mira dhe ne modelin e implementuar ne disa njesi te qeverisjes vendore, projekt i financuar nga USAID. Pra, e thene keshtu, sistemi duhet te jete i gatshem dhe te mos kete nevojë per zhvillim. Te gjitha ndryshimet qe mund te kerkohen nga Bashkia Kolonje te mund te arrihen me ane te konfigurimit dhe parametrizimeve.

Sistemi qe do te propozohet duhet te jete lehtesisht i konfigurueshem dhe ne perputhje te plote me rregullat dhe standardet e kontabilitetit publik dhe legjislacionin ne fuqi. Gjithashtu duhet konceptuar me funksione te zgjerueshme ne te ardhmen.

Zgjidhja do te synoje te mbuloje plotesisht te gjitha aktivitetet ne lidhje me aktivitetet financiare te njesive.

Modulet kryesore perberese te ketij sistemi duhet te jene:

- Moduli i Librit te madh
- Moduli i Blerjeve dhe Shpenzimeve
- Moduli i Sherbimeve
- Moduli i Inventarit dhe Magazines
- Moduli i Aseteve Fikse
- Moduli i komunikimit me sistemet e tjera qeveritare
- Moduli i administrimit te sistemit

#### **Hapesira gjeografike qe do te mbulohet**

Bashkia Kolonjë dhe 7 njesite ne varesi te saj.

#### **Grupet e synuara**

Ky projekt synon grupet e meposhtme te interesit:

- Te gjithe punonjesit e Bashkise Kolonjë dhe njesive administrative ne varesi te saj.
- Punonjesit e zyrave te Teknologjise se Informacionit të Bashkisë Kolonjë dhe punonjësit e 8 njesive administrative të saj
- Punonjesit e zyrave te Financave dhe Kontabilitetit të Bashkisë Kolonjë dhe punonjësit e 8 njesive administrative të saj
- Te gjithe palet e treta, biznese dhe qytetare te qytetit te Kolonjës te cilet marrin sherbime nga kjo bashki dhe njesite administrative ne varesi te saj.

## Siguria e sistemit

Siguria e te dhenave duhet te arrije ne nivel rekordi specifik per çdo tabele te dhenash. Ne menyre qe tu jepet akses perdoruesve sipas nevojave, akses mund te jete specifik per disa funksione si psh: lexim te dhenash, modifikim, ekzekutim dhe fshirje.

Te gjitha te dhenat e ruajtura ne aplikacion, perfshire edhe ato te konfigurimit si dhe te perdoruesve te sistemit duhet te ruhen ne nje baze te dhenash RDBMS e cila ploteson kerkesat ne lidhje me integritetin e te dhenave dhe sigurine.

Sistemi duhet te suportoje mjete efçente auditimi, mjete efçente per aktivizimin e ruajtjes se historikut dhe te ndryshimeve, percaktimin e historikut te se shkuars dhe te ardhmen (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja duhet te realizohet per te dhena specifik ne tabela, te cilat mund te zgjidhen nga administratoret e sistemit.

Duke parë rëndësinë e aplikacionit i cili do të mundësohet, pasi nëpërmjet tij do të realizohet gjithë procesi i informimit të publikut mendojme se duhet të parashikohen në mënyre objektive rreziqet në fushen kibernetike të aplikacionit dhe të infrastrukturës.

Objektivat më të rëndësishëm në lidhje me sigurinë e informacionit janë garantimi dhe mbrojtja e integritetit, e disponueshmërisë dhe e konfidencialitetit të informacionit. Niveli i përshtatshëm i mbrojtjes mund të arrihet vetëm duke garantuar që të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit mbulohen në mënyrë të vazhdueshme dhe metodike.

Testimi në mënyrë të skeduar i nivelit të sigurisë mund të realizohet gjatë fazave përgatitore, zhvillimit të sistemit Software si edhe në vazhdim. Për të siguruar informacionin duhet të parashikohen në infrastrukture pajisje mbrojtëse si edhe aplikacione të cilat monitorojnë performancën edhe mbrojnë sistemet e instaluar nga aplikacionet keqbërëse.

Me poshte jepet percaktimi i nivelit te sigurisë sipas klasave të disponueshmërisë, integritetit, konfidencialitetit (referuar neneve 17, 18 dhe 19 të VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”:

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit eshte bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	
<input type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U
<input type="checkbox"/> D2	<input type="checkbox"/> I2	<input checked="" type="checkbox"/> K2	<input type="checkbox"/> M
<input checked="" type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

- Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmeria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.
- Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmeria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.
- Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmeria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

### ***Detyrat specifike***

Ne kuader të qëllimit kryesor të këtij projekti për ndërtimin e sistemit të taksave dhe atij financiar e kontabel, i gjithë projekti duhet të ndërtohet mbi detyrat e mëposhtme:

1. Përcaktimi i planit të punës për ekzekutimin e projektit
2. Ngritja e grupeve të punës nga të dy palët e interesuara
3. Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizës së kërkesave
4. Dizajnimi dhe përcaktimi i arkitektures së sistemit
5. Implementimi i sistemit Financiar sipas praktikave të ndjekura në bashkitë e tjera ku mund të jetë implementuar.
6. Konfigurimi i sistemit dhe migrimi i të dhënave fillestare nga historiku që vetë bashkia zoteron. Të dhënat do të jepen kontraktorit dhe ai do të jetë përgjegjës për importimin e tyre në sistemin e ri.
7. Testimi dhe dokumentimi i pranimit të përdoruesit
8. Përgatitja e materialeve udhëzuese dhe trajnimi i përdoruesve
9. Marrja në dorezim e projektit nga autoriteti kontraktues
10. Raportimi i çdo faze të projektit të menaxherit të projektit.

## **LOGJISTIKA DHE KOHA**

---

### **Vendndodhja**

Bashkia Kolonjë dhe njesitë administrative në varesi të saj.

### **Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave**

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nisur nga kjo datë.

## RAPORTIMI

---

### Kerkesat e Raportimin

Kontraktuesi do te paraqese raportet e meposhtme ne gjuhen shqipe ne original dhe ne 2 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet te prodhohet pas 3 jave, nga fillimi i implementimit. Ne raport Kontraktuesi duhet te pershkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi ne mbledhjen e te dhenave, çdo veshiresi te pritura ose te hasura perveç programit te punes apo udhetimeve te stafit. Kontraktuesi duhet te vazhdoje me punen e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues te dergoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit perfundimtar** i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke perjashtuar anekset) Ky raport duhet te dorezohet jo me vone se nje muaj para perfundimit te periudhes se zbatimit te detyrave.
- **Raporti final** me te njejtat specifika si drafti i raportit perfundimtar, inkorporimin e komenteve te pranuar nga palet ne draft raport. Afati i fundit per dergimin e raportit perfundimtar eshte 10 dite pas marrjes se komenteve ne draft raportin perfundimtar. Analizat e detajuara qe i mbeshtesin rekomandimet do te prezantohen ne anekset ne raportin kryesor. Raporti perfundimtar duhet te sigurohet se bashku me faturen perkatese.

### Dorezimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i permendur me siper duhet t'i dorezohet Menaxherit te Projektit te identifikuar ne kontrate. Menaxheri i Projektit eshte pergjegjes per aprovimin e raporteve.

## KOMUNIKIMI ME SISTEME TE TJERA

---

Nuk do te kete komunikim me sisteme te tjera.

## GARANCIA

---

Ne kuader te kesaj kontrate kompania e kontraktuar duhet te mbuloje nje periudhe tre mujore garancie te produktit ne te cilen perfshihen korrigjim gabimesh, nderkohe qe per serverin duhet te ofrohet minimalisht 3 vjet garanci.

## Mirembajtje

---

Bashkia Kolonje ka si qellim te siguroje vijueshmerine, disponibilitetin dhe performance te larte te sherbimeve te sistemit financiar dhe ate te taksave. Ne kuader te ketij bashkepunimi kompania duhet te ofroje sherbimet e listuara me poshte per nje periudhe 4-vjecare pas marrjes ne dorezim te sistemit.

- Fillimi i diagnostikimeve on site / on line, dhe mbeshtetje per "debugging" brenda dites te punes nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor dhe perfundim te veprimeve korigjuese brenda 24-48 oreve nga ky njoftim.
  - Mbeshtetje me linje telefonike ne gjuhen Shqipe, deri ne 2 ore pergjigje ne nje dite pune.
- Emergjenca per thirrje, sherbim vizitash ne vend (on site) brenda dites te punes nga marrja e kerkeses se Autoritetit Kontraktor.
  - Sherbim on site / on line "per thirrje" per personalizimin e paketes se programit, e vlefshme brenda dites pasardhese te punes.
- Mirembajtje te Bazes se te Dhenave.
- Asistence per personelin IT per:
  - Analize te te dhenave.
  - Gjenerim te raporteve te performances.
- Helpdesk te jete aktiv 8 ore nga e Hena ne te Premten (08:00 – 16:00).
- Korigjimi i gabimeve te funksionaliteteve.
- Ri-instalimi i sistemit me te gjitha komponentet e tij, do te jete detyrimi i kompanise se bashku me konfigurimet perkatese per venien ne pune te ketij programi (server dhe kliente).
- Çdo ndryshim i kryer si pasoje e ndryshimeve ligjore finaciare dhe fiskale duhet te kryhet me prioritet brenda nje afati te tille qe nuk do te sjelle pengese ne realizimin e detyrave te Deges se Taksave te cilat mbeshteten mbi kete sistem.
- Kompania duhet te jete disponibel per ndryshimet ne raportet perkatese sipas kerkeses se bere nga Bashkia Kolonje si per ato ekzistuese dhe per raporte te reja ne kuader te permiresimit te punes ne sektorin financiar.
- Ndryshimi i raporteve dhe faturave te cilet do te printohen ne pamjen vizuale mund te jene subjekt permiresimi.
- Konfigurimi i klienteve dhe userave te rinj apo i atyre ekzistues ne Bashkine Kolonje.
- Trajnimi i personelit perdorues per ndryshimet apo permiresimet e tij ne ambientet e Bashkise Kolonje.
- Pergatitje te raporteve 3-mujore te detajuara lidhur me punen e kryer nga kompania.

## PLANIFIKIMI I BUXHETIT PER NDERTIMIN E SISTEMIT

Bazuar ne kerkesat funksionale te sistemi dhe infrastrukturen se parashikuar, ne tabelen e meposhtme jepet nje vleresimet fillestare per angazhimet financiare per realizimin e ketij projekti. Gjate percaktimit te vlerave fillestare jane marre parasysh projekte te ngjashme.

NR.	Pershkrim	Sasi	Njesi	Cmim njesi	Vlere (Lek)
<b>1</b>	<b>Implementimi i sistemit te Financiar</b>				
1.1	Licenca sistemi COTS (perdoruesit)	5	Cope		
1.2	Licenca server RDBMS	1	Cope		
1.3	Licenca perdorues RDBMS	5	Cope		
1.4	Sherbime implementimi i sistemit (konfigurime, parametrizim, testim)	1	Njesi		
<b>2</b>	<b>Trajnimi i perdoruesve</b>				
<b>3</b>	<b>Server</b>	1	Cope		
	<b>TOTALI 1+2+3</b>				
<b>4</b>	<b>Mirembajtje</b>	4	Vite		
	<b>Total 1+2+3+4 lekë me TVSH</b>				

## AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT

Ne tabelen e meposhtme jepen ne vija te pergjithshme afatet kohore per implementimin e sistemit, bazuar edhe ne eksperienca te sistemeve te ngjashme ky projekt normalisht kerkon rreth 6 muaj per tu implementuar.

Nr	Emertimi i fazes / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7-51
1	Levrimi i serverit, Instalimi dhe konfigurimi i sistemit							
2	Integrimi me sistemet e tjera.							
3	Migrim i te dhenave fillestare							
4	Testimi dhe trajnimi perdoruesish							
5	Mirembajtje							

## TE DREJTAT E KODIT TE APLIKACIONIT

---

Cdo e drejte mbi kodin burim apo çdo dokumentacion qe ka te beje me ndryshimet qe kontraktori do te beje mbi sistemin, do t'i kaloje perfituesit ne format elektronik dhe ne letër.

## KERKESAT FUNKSIONALE

---

Sistemi duhet te bazohet ne paketa programi gjithepershiresë nderkombetare te ndertuara ne menyre modulare dhe bazuar ne role dhe detyra. Çdo modul duhet te jete plotesisht i integruar me pjeset e tjera te sistemit.

Modulet kryesore te sistemit duhet te jene si me poshte:

- Moduli i Librit te madh
  - Moduli i Blerjeve dhe Shpenzimeve
  - Moduli i Sherbimeve
  - Moduli i Inventarit dhe Magazines
  - Moduli i Aseteve Fikse
  - Moduli i komunikimit me sistemet e tjera qeveritare
  - Moduli i administrimit te sistemit
- 
- Sistemi duhet te jete i mbeshtetur ne aplikacione COTS te cilat kane baze te gjere implementimi ne Shqiperi, rajon dhe ne Evrope.
  - Sistemi duhet te lejoje dhe mundesoje pershtatjen sipas standarteve kombetare te kontabilitetit publik ne fuqi.
  - Sistemi duhet te jete i integrueshem me paketen office excel, word, outlook.
  - Sistemi duhet te jete i integrueshem me 'active directory' dhe te suportoje konceptin 'Single Sign-on'.
  - Sistemi duhet te bazohet ne nje pakete programi gjithepershiresë nderkombetare te ndertuar ne menyre modulare dhe bazuar ne role dhe detyra. Çdo modul duhet te jete plotesisht i integruar me pjeset e tjera te sistemit.
  - Sistemi duhet te funksionojë me nje baze te dhenash te vetme
  - Paketa e zgjedhur duhet te jete fleksibel ne parametra, dhe pershtatjet specifike te japin efektin e duhur, duke shmangur nevojën per te bere porosi per zhvillimin e programit,.
  - Sistemi duhet te kete si pjese integrale nje ambjent zhvillimi te pajisur me mjetet e duhura per personalizim menush, objektsh, formash, faqesh dhe raportesh, pa patur nevojën per te nderhyre ne 'source code' te sistemit.

- Çdo funksion procesimi i sistemit duhet te bashkeveproje me funksionet e tjera te sistemit ne menyre sa me te integruar, duke minimizuar nderhyrjet e perdoruesit.
- Sistemi duhet te shoqerohet me pershkrime te detajuara te platformes se teknologjise se programit (ambjentin e zhvillimit, serverat e aplikimit, çdo program standard shtese dhe/ose ambiente ekzekutimi) qe jane perdorur per zhvillimin e sistemit.
- Nderfaqja e sistemit duhet te jete e modelit “Role Based”, e konfigurueshme sipas profileve te punonjesve.
- Siguria e te dhenave duhet te arrije ne nivel rekordi specifik per çdo table te dhenash. Ne menyre qe tu jepet akses perdoruesve sipas nevojave, akses mund te jete specifik per disa funksione si psh: lexim te dhenash, modifikim, ekzekutim dhe fshirje.

## Funksionalitete dhe Bllokskema

Funksionalitetet e zgjidhjes se ofruar duhet te jene si me poshte:

*Sistemi i Administrimit Financiar dhe kontabel i cili duhet te mundesoje:*

- i. Administrimin e llogarive kontabel**
  - Plan kontabel sipas standarteve ne fuqi
  - Personalizim te planit kontabel sipas nevojave lokale
  - Percaktim te skemave kontabel per regjistrimet
  - Ditar standart kontabilizimesh
  - Ditar periodik kontabilizimesh
  - Regjistra sintetik dhe analitik veprimesh ne llogari
  - Mbi 20 raporte per analiza te veprimeve ne llogari
- ii. Administrimin e projekteve**
  - Administrim i veprimeve me projekte te vecanta
  - Ndjekjen e situacioneve
  - Ndjekjen e zbatimit te planit
- iii. Administrimin e granteve**
  - Administrim i plote te ciklit te granteve
- iv. Administrimin e shpenzimeve**
  - Administrim i plote i regjistrimit dhe evidentimit te shpenzimeve.
  - Ndjekje dhe evidentim i kreditoreve
  - Ndjekje dhe analiza te veprimeve me furnitoret.
  - Ndjekje te afateve te pagesave ndaj furnitoreve.
- v. Administrimin e investimeve**
  - Ndjekje e plote e veprimeve te lidhura me investimet.
  - Kontroll i statusit te realizimit



**vi. Administrimin e inventarve**

- Kartelizim te informacionit te inventarit
- Evidentim dhe regjistrim te inventareve
- Procedura per vlersimin dhe rivlersimin e inventareve
- Mbajtje te gjendjeve te magazinave
- Blerje dhe shitje te inventareve
- Transferim te inventareve

**vii. Administrimin e aseteve**

- Kartelizim te informacionit te aseteve
- Percaktim te njesive dhe personave pergjegjes per asetet
- Vlersim te vlerave te aseteve
- Procedura per amortizimin e aseteve sipas politikave dhe legjislacionit ne fuqi.
- Raporte te printueshme dhe analitike

**viii. Administrimin e regjistrimeve periodike**

- Procedura periodike rivlersimi te inventareve
- Procedura arkivimi te dokumentave

**ix. Administrimin e buxheteve**

- Pergaditje buxhetesh ne nivel llogarie
- Krahasim automatik midis planit dhe faktit
- Konsolidim buxhetesh nepermjet njesive
- Raporte dhe analiza

**Raporte**

Ne saje te modulit te Raportimit BI ne sistemin e ri financiar qe duhet te implementohet, duhet te gjenerohen keto raporte te gatshme:

- Bilanci Kontabel
- Kartela e Llogarive
- Te ardhura dhe shpenzimet
- Cash Flow
- Levizja e kapitalit
- Levizja e llogarive
- Gjendja e llogarive
- Gjendja e artikujve
- Kartela e artikujve
- Raporte te faturimeve
- Raporte te arketimeve dhe pagesave
- Raporte te derdhjeve bankare dhe terheqjeve bankare
- Raporte te gjendjes se inventarit
- Raporte te librave te shitjes, blerjes sipas formateve te miratuara nga legjislacioni ne fuqi
- Raporte te tjera te personalizuar sipas formatit te kerkuar nga institucioni.

- Per te gjitha raportet te krijohet mundesia e eksportit ne excel pdf etj.

Ndërtimi i raporteve si dhe ndryshimi i tyre sipas kërkesave specifike do të jenë objekt zhvillimi i vazhdueshëm midis operatorit fitues dhe kontraktorit.

## KERKESAT TEKNIKE

---

### Kerkesat teknike per sistemin

#### Specifikime teknike te serverit

<b>Procesori</b>	<b>1 cpu 4 core, me performancë minimale <math>\geq</math> 9900 sipas benchmark të publikuar në <a href="http://www.cpubenchmark.net">http://www.cpubenchmark.net</a>"</b>
<b>Memorja</b>	<b>16 GB Registered DIMMs</b>
<b>Storage Controller</b>	<b>SAS Raid Controller, qe suporton: RAID</b>
<b>Nr. maksimal i vendeve per HDD</b>	<b>Min. 4 HDD, hot-plug</b>
<b>HDD te perfshira dhe konfigurimi I RAID-it</b>	<b>4 x HP 300GB GB SAS 15.2 HDD (ne RAID 10)</b>
<b>Disku Optik</b>	<b>DVD-ROM/CDRW drive</b>
<b>Rrjeti</b>	<b>minimumi 2 x 1 Gb Ethernet; 1 Management Port</b>
<b>Power supply</b>	<b>Power Supplies (Two Hot Plug Redundant PS)</b>
<b>Operating Systems</b>	<b>Microsoft Windows Server (2012 R2 ose 2012)</b>
<b>Garancia</b>	<b>3 Vjet</b>